



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 195, Datë 30.08.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “DERBI-E” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ANTENA” ME FUQI TË
INSTALUAR 1105 KW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 30.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena” me vendodhje në lumin e Zallit të Shtamës, Bashkia Mat, Qarku Dibër, me fuqi të instaluar 1105 kW,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 167, datë 19.07.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Derbi -E” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me fuqi të instaluar 1105 kW.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 55/52 Prot., datë 24.07.2018, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe me shkresën nr. 503/1 Prot., datë 31.07.2018, ka përcjellë pranë subjektit kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar, kërkesë e cila është përsëritur me shkresën nr. 503/3 Prot, datë 16.08.2018.
- Në vijim të sa më sipër subjekti “Derbi-E” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 503/4 Prot., datë 27.08.2018, ka përcjellë në ERE gjithë dokumentacionin e munguar të sipërcituar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “DERBI - E” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “Derbi -E” sh.p.k, mbështetur në pikën 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Eergjisë Elektrike”, si dhe VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Per miratimin e rregullave dhe procedurave te ndertimit të kapaciteteve te reja prodhuese të energjise elektrike, qe nuk jane objet konçensionit” i ndryshuar, ka aplikuar në MEI dhe ka marrë Miratimin Përfundimtar nr. 5184/1Prot, datë 20.07.2017, për ndërtimin e HEC-it “Antena”, me kapacitet 1105 kW.
- MEI pas miratimit përfundimtar nr. 5184/1Prot, datë 20.07.2017, ka lidhur me Mbajtesin e Miratimit Përfundimtar Shoqërinë “Derbi -E” sh.p.k kontratën nr.1859 Rep; nr. 833/2 Kol, datë 07.08.2017, sipërcituar.
- Subjekti ka paraqitur në ERE me shkresën e protokolluar me tonën Nr. 503/4, datë 27.08.2018, Kontraten e Qirase datë 08.05.2017, të lidhur midis Bashkisë Mat, me cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Derbi-E” sh.p.k, në cilësinë e qiramarrësit, të amenduar referuar shkresës së Bashkisë Mat nr.121Prot, datë 16.01.2018 (Amendimi nr.1 i Kontratës së Qirasë datë 08.05.2017 me shoqërinë Derbi-E, ku neni 3 i kontratës i lidhur për afatin 1 vjeçar bëhet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë përsëritje). Palët kanë nënshkruar për dhënien me qira të fondit pyjor kullësor publik, me sipërfaqe 5.921 km (hapje kanalesh, shtrirje tubacionesh, ndertim rruge, ndërtim linje tensioni 10 kv, për ndërtimin e HEC “Antena”, vetëm sipas qëllimit, gjatësive dhe siperfaqeve të miratuara nga Bashkia Mat, për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe leje mjedisore.
- OSHEE me shkresën nr. 29784/1 Prot, datë 11.12.2019 ka miratuar lejen për lidhjen e HEC “Antena” në rrjetin elektrik të shpërndarjes.
- Subjekti “Derbi-E” sh.p.k ka marrë miratimin përfundimtar nga MIE për një afat 49 vjeçar, por nga ana tjetër, ERE në zbatim të nenit 38, të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe neni 5 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.
- Aplikimi i shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3). Plotësuar.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5). Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Derbi -E” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Antena” me fuqi 1105 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Shoqëria “Derbi -E” sh.p.k në përfundim të afati 5 – vjeçar të kontratës së qirasë me Bashkinë Mat, të depozitohet në ERE kontratën e rifreskuar.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI